



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.14

Prishtinë, më 10.4.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu, Adem Mikullovc, Arbërie Nagavci, Albulena Balaj - Halimaj dhe Verica Çeraniq.

Munguan: Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Fidan Rekalju.

Përfaqësues të tjerë: Dardan Mehmeti, nga platforma parashkollore.com, përfaqësues të KDI-së dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.3.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.3.2018;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 27.3.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;

Ismajl Kurteshi, kryetar, në fillim të mbledhjes propozoi që shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, të shtyhet për shkak të kohës së shkurtër pasi që Komisioni pas një ore do të mbajë tryezë në lidhje me arsimimin e personave me nevoja të veçanta, dhe me këtë rast propozoi të bëhet prezantimi i platformës parashkollore, të cilën do ta paraqes Dardan Mehmeti.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit.

Në vazhdim, kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit, në lidhje me shkresën e prof. Mentor Sopjani, e cila është adresuar rreth parregullsive që janë bërë nga ana e Komisionit të MASHT-it përkitazi me aplikimin e tij për anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).

Ai tha, se meqenëse i njëjti nuk është ftuar në intervistë, konsiderohet se është bërë shkelje e Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga MASHT-i dhe lidhur me këtë do të kërkojmë sqarim nga ministri.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që gjatë dy ditëve në vijim të ftohet ministri i MASHT-it, në mënyrë që të sqarohet ky rast si dhe të shqyrtohen anëtarët e propozuar për Këshillin Shtetëror të Cilësisë.

Në vijim të mbledhjes fjala iu dha Dardan Mehmetit nga platforma parashkollore Pikë.com, me qëllim të prezantimit të projektit të platformës që përfshin sistemin parashkollor të edukimit.

Ai tha se kjo platformë funksionon në sistemin parashkollor në shumë qytete në kopshte private, ku përfshin administratën, edukatorët dhe prindërit e fëmijëve parashkollorë, dhe së shpejti pritet që sistemi i njëjtë të aplikohet edhe në kopshtet publike dhe do të startohet me këtë në Prishtinë dhe në Malishevë, ku fëmijët përmes kësaj, përveç tjerash mësojnë dhe gjuhën angleze.

Adem Mikullovc, tha se edukimi i fëmijëve do të duhej të ishte çështje primare në platformën e prezantuar, duke e vënë fokusin në parandalimin e përdorimit të tepërt të lojërave kompjuterike nga ana e fëmijëve përmes angazhimit të tyre në programe artistike, të cilat ndikojnë në edukimin e fëmijëve, specifikisht në mësimin e gjuhës shqipe, të cilën e konsideron si mangësi.

Mufera Shinik, tha se a është paraparë në program edhe mësimi i gjuhës shqipe për fëmijët të cilët nuk e kanë gjuhë amtare gjuhën shqipe?

Nezir Çoçaj, tha se e përkrahë një sistem të tillë të platformës elektronike, meqë mësimet në fëmijërinë e hershme ndikojnë në zhvillimet e tyre dhe kërkon që në këtë platformë të përfshihet metodologjia e punës si dhe të kërkojmë nga Ministria të përkrahët një platformë e tillë dhe që e njëjta të përfshihet edhe në çerdhet publike dhe në shkolla.

Ismail Kurteshi, në fund falënderoi prezantuesin e platformës dhe theksoi që kjo platformë do të ketë përkrahjen e Komisionit në procesin e implementimit.

4. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi